

DREJTUAR: Z. PETRIT AHMETI
KRYETAR I BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE

Lënda: Komentet e Shoqatës Shqiptare të Furnizuesve të Energjisë Elektrike lidhur me aplikimin për tarifën e transmetimit nga ana e Operatorit të Sistemit të Trasmetimit

I nderuar Z. Ahmeti,

Shoqata Shqiptare e Furnizuesve të Energjisë Elektrike (në vijim AAES) është vënë në dijeni të aplikimit për tarifën e transmetimit nga ana e Operatorit të Sistemit të Trasmetimit (OST) përmes publikimit të saj për konsultim në Website-in e ERE.

Në aplikimin e saj, OST ka kërkuar/propozuar rritje të tarifës së transmetimit për periudhën 2025 – 2027 në masën 1.23 Lek/kWh në rastin e furnizimit për faturim dhe 0.95 Lek/kWh në rastin e faturimit për përdorues rrjeti.

Përmes përcaktimit “përdoruesit e rrjetit” OST, qartazi, kërkon tarifimin e aktivitetit të tregtimit të energjisë elektrike, aktiviteti i cili përfshin importin, eksportin, tranzitin si dhe tregtinë e energjisë elektrike në rrjetin e brendshëm.

Lutem gjeni në vijim pozicionin/komentet dhe AAES.

- 1) Në opinionin e AAES, kërkesa e OST, haptazi, bie ndesh me Ligjin Nr. 43/2015 për “Sektonin e Energjisë Elektrike” (ndryshuar me ligjin nr. 7/2018, datë 15.2.2018) neni 21, pika 5 sipas të cilit: Nuk aplikohen tarifa për aksesin në rrjet për transaksionet individuale të eksportit dhe/ose transiteve të deklaruara.
- 2) Në të njëjtën frymë dhe pozicion më lart është edhe Traktati i Komunitetit të Energjisë ku Shqipëria bën pjesë, Rregullorja (BE) Nr. 714/2009 e Parlamentit Europian dhe e Këshillit date 13 Korrik 2009, Direktiva Nr. 2019/944 e Parlamentit Europian dhe e Këshillit date 5 Qershor 2019 si dhe Rregullorja (BE) Nr. 2019/943 e Parlamentit Europian dhe e Këshillit date 5 Qershor 2019.
- 3) Në arsyetimin e tonë, aplikimi i një tarife transmetimi për energjinë e tregtuar do të ishte një hap prapa në zhvillimin e tregut të energjisë elektrike duke patur impakt tejet negativ në këtë të fundit.

Impakti i parë do të ishte një rritje e çmimeve të energjisë në të gjithë vendin dhe në të gjitha llojet e aktivitetit. Kjo rritje do të afektonte energjinë e tregtuar në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike (APLEX), energjinë e tregtuar lirisht mes paleve në tregun OTC, importin, eksportin dhe tranzitin e energjisë elektrike.

Shtrirja e aplikimit të tarifës së OST për energjinë e tregtuar APLEX bie ndesh me parimet e “Market Coupling” si dhe përballet me vështirësitë teknike në implementim (identifikimin e sasive) ku si shëmbull mjafton të përmëndim energjinë e tregtuar në APLEX. Ngrihet pyetja se cilat sasi të tregtuara në ALPEX do të jenë subjekt i tarifës së transmetimit. Duke supozuar që tarifa do të aplikohet vetëm për sasitë e tregtuara në Shqipëri, atëherë do të kishim jo vetëm “diskiminim tarifor” të këtyre sasive por do të gjëndeshim para një “bariere” izoluese të ALPEX në Shqipëri nga tregjet e tjera.

Me qëllim fokusin në praktikat më të mira të industrisë në vendet europiane, në website zyrtar të ACER, seksioni publikimet, gjendet Raporti i ACER për metodologjitë e tarifave të transmetimit dhe shpërndarjes (ACER REPORT ON TRANSMISSION AND DISTRIBUTION TARIFF METHODOLOGIES IN EUROPE 2023). Linku https://www.acer.europa.eu/sites/default/files/documents/Publications/ACER_electricity_network_tariff_report.pdf

Sic vërehet qartazi në raportin e sipër-cituar, tarifat e transmetimit/shpërndarjes përfshijnë në sferën e tyre të aplikueshmërisë vetëm përdoruesit fizik të rrjetit që janë prodhuesit/gjeneratorët si dhe konsumatorët.

Impakti i dytë do të ishte rritja e çmimit të energjisë për konsumatorët fundorë pasi Furnizuesit e Kualifikuar, në kontrast me çka është situata sot, do të ishin të detyruar të blenë energji elektrike subjekt i tarifës së transmetimit (përpara së të lëvrohet të konsumatorët).

Impakti i tretë që vlen të përmendet është konfuzioni. Gjëndur në pamundësinë thujse absolute të gjurmueshmërisë së energjisë së tregtuar, e njëjta sasi energjie riskon të tarifohet më shumë se 1 herë duke qënë se ajo mund të tregtohet ndërmjet dy apo më shumë tregtarësh. Një situatë e tillë do të sillje konfuzion/pasiguri në aktivitetin mes aktoreve present në tregun vendas por edhe në marrëdhëniet e tyre me organet tatimore.

- 4) Sipas Metodologjisë miratuar nga ERE, tarifa e transmetimit merr për bazë kostot kapitale dhe operative.

Sa takon kostove operative, OST i ndan ato në:

- i. kosto për energji,
- ii. kosto për shfrytëzim,

Referuar aplikimit të paraqitur nga OST, për periudhën e viteve 2022-2024 kostoja për energji (mbulimi i humbjeve, shërbimet ndihmëse e të balancimit) ka zënë një peshë prej 29% tek tarifa aktuale. Çuditërisht, për periudhën 2025-2027, kostoja për energji parashikohet të zërë një peshë prej rreth gati 50% duke rritur shpenzimet për:

- a) mbulimin e humbjeve (nga 1'940 mil. Leke në 2'549 mil. lekë, (me një ndryshim në rritje me rreth gati 30% nga viti i kaluar)
- b) shërbimet ndihmëse (nga 1'101 mil. Lekë në 1'759 – 2'377 mil. Lekë (me një ndryshim në rritje me rreth gati 55% - 100% nga harku kohor reference 3 vite).

Pa dashur të shprehim gjykimin apo arrijmë në konkluzione të gabuara, mendojmë se shifrat më lart nuk reflektojnë situatën reale dhe kjo argumentuar si vijon:

- pika a) më lart, së paku, nuk konsideron çmimet e pritshme të energjisë për periudhën 2025 – 2027 të cilat janë dukshëm në nivel më të ulët se vitet më parë.
- pika b) më lart nuk merr në konsideratë Raportin e Aktivitetit. Në Raportin e Aktivitetit të OST për periudhën Janar- Qershor 2024, OST raporton se kostoja për blerjen e shërbimeve ndihmëse ishte planifikuar në rreth 620 mil. Lekë ndërkohë vlera faktike është 232,8 milione Lekë. Thënë ndryshe, vetëm për 6 mujorin e parë të vitit 2024, janë shpenzuar rreth 387 mil. Lekë më pak nga sa ishte parashikuar. Dukshëm, parashikimi nga OST për rritje të koston për shërbimet ndihmëse nuk është i vlefshëm.
- Së fundmi, në raportin e OST bie në sy edhe fakti se OST priste 0 Lek të ardhura nga tregu i balancimit por vetëm në 6 mujorin e parë të këtij vitit OST ka siguruar të ardhura prej rreth 763 mil. Lekë. Kjo situatë është dukshëm në kundërshti me parashikimet e Rregullave të Tregut të Balancimit, sipas të cilave OST duhet të ketë një pozicion neutraliteti financiar! Në përgjigjen e saj ndaj ERE-s, Nr. 6004/2 Prot., datë 10.07.2024 OST nuk përfshin pozicionin e saj neto të siguruar nga aktiviteti i tregut të balancimit, thenë ndryshe fitimin. Në opinionin e AAES, parashikimi i Rregullave e Tregut te Balancimit (neni 3.6.a.1) në lidhje me

rezultatet neto të disbalancave me PPB-të nuk është marrë në konsiderate nga OST.

- 5) Së fundmi, dëshirojmë të vëmë theksin edhe tek një pikë tjetër e rëndësishme siç është transparenca. AAES vlerëson rolin e OST në rritjen transparencës që tregu ka arritur deri më tani.

Gjithsesi, sërish mbeten për tu eliminuar disa pengesa sic janë vonesat e theksuara në publikimin e çmimeve të disbalancave (deri në 10-15 ditë pas ditës së tregtimit) apo publikimi i tejet i vonuar i rezultateve e Ankandeve Ditore të Angazhimit për Shpërndarje (të cilat publikohen vetëm me baza mujore dhe tepër vonë).

Publikimi e këtyre informacioneve në kohë sa më të shpejtë (por jo më shumë se 30 min. nga lëvrimi sipas Rregullores 2019/943, datë 5 Qershor 2019) do të rriste besueshmërinë e tregut të balancimit dhe për shumë kompani do të shërbente si faktor nxitës për pjesmarje. Rrjedhimisht, do të kishim rritje të efikasitetit dhe optimizim të kostove të balancimit.

Konsideruar sa më lart, AAES është e mendimit se nuk egziston asnjë kusht për të cilin duhet të ketë rritje të nivelit aktual të tarifës së transmetimit apo të zgjerohet baza e aplikimit të saj. Një gjë e tillë do të sillte rritje të çmimit të furnizimit me energjisë elektrike për konsumatorët fundorë dhe do të bëhej pengesë për zhvillimin e Tregut të Energjisë Elektrike në Shqipëri.

Lutemi marrjen në konsideratë të kërkesave tona.

Ju falenderojmë paraprakisht për bashkëpunimin.

Me respekt,

**KRYETARI
OLSI TURABI**

